

nuar. Me gjithë kushtet e vështira klimaterike, sidomos gjatë dy vjetëve të fundit të pesëvjeçarit, në vitin 1960, në krahasim me vitin 1955, prodhimi bujqësor ishte 25 për qind më i madh.

Shtimi i prodhimit industrial e bujqësor, rritja e rendimentit të punës dhe ulja e kostos së produkteve qenë faktorët kryesorë që përcaktuan një ngritje të dukshme të mirëqenies materiale e të nivelit kulturor të popullit. Paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve si edhe të ardhurat reale të fshatarësisë u rritën më tepër seç parashikonte plani. Në vitet e pesëvjeçarit të 2-të u bënë 6 ulje çmimesh të mallrave të përdorimit të gjerë, nga të cilat popullsia pati një përfitim prej 7 miliardë e 200 milionë lekësh (të vjetër). Vëllimi i qarkullimit të mallrave u shtua me një ritëm 2-3 herë më të madh se rritja natyrore e popullsisë.

Arsimi u ngrit në një shkallë më të lartë. Më 1957 u krijua Universiteti i Tiranës, qendra më e madhe arsimore e shkencore e vendit. Më 1960, në çdo pesë vetë të popullsisë njëri mësonte. Numri i kuadrove të lartë, në krahasim me vitin 1955, u trefishua. Jeta mesatare e popullsisë arriti në 62 vjeç.

Plotësimi i detyrave të planit të 2-të pesëvjeçar krijoi pikënisje të reja për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës në rrugën e ndërtimit socialist të vendit.

4. KRITIKA KUNDËR PIKËPAMJEVE REVIZIONISTE DHE VEPRIMTARISË PËRÇARËSE TË UDHËHEQJES SOVJETIKE

Mbledhja e Partive Komuniste e Punëtore e nëntorit 1957 vetëm e frenoi për një farë kohe revizionizmin, por nuk e ndaloi zgjerimin dhe thellimin e tij në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Përhapja e mëtejshme e revizionizmit ndërkombëtar

Revizionistët jugosllavë e cilësuan hapur Deklaratën e mbledhjes «si një mohim të Kongresit XX të PKBS», si «një hap prapa», si «një kthim në stalinizëm». Ata shpërthyen kundër përmbajtjes së saj revolucionare një luftë të ashpër dhe nuk vonuan t'i

kundërvinin asaj «programin» e tyre antimarksist që e shpallën më 1958 dhe e paraqitën si «një manifest ndërkombëtar».

Ndërkaq, udhëheqja sovjetike me Hrushovin në krye nuk i përfillte aspak konkluzionet revolucionare të Deklaratës së përbashkët, por vazhdonte të propagandonte e të vinte në jetë konkluzionet revizioniste të Kongresit XX. Ajo nuk linte rast pa përdorur për t'u afruar gjithnjë e më shumë dhe për të vendosur një bashkëpunim të ngushtë me imperialistët amerikanë. Hrushovi shpalli botërisht të padrejtë dhe çnjerezore çdo lloj lufte në kushtet e sotme! Ai i kërkoi OKB-së të vinte në jetë «çarmatimin e përgjithshëm e të plotë» për çdo vend e për çdo popull, me përjashtim të policisë në çdo shtet «për të mbrojtur rendin» (!) dhe të «forcave të armatosura ndërkombëtare» që duhej të krijoheshin pranë OKB-së, sigurisht për të shtypur luftërat dhe kryengritjet popullore. Ai filloi të përhapte idenë e rreme se që nga viti 1960 do të krijohet «një botë pa armë, pa ushtri, pa luftëra!».

Politika që ndiqte grupi i Hrushovit kishte karakter demagogjik, eklektik dhe kontradiktor, tipar ky për çdo lloj revizionizmi. Këtu i lavdëronte SHBA dhe kërkonte bashkëpunim të ngushtë me ta, aty i shante si agresorë dhe xhandarë botërorë. Një herë e quante presidentin amerikan «mik», «njeri të madh», «të arsyeshëm» e «paqedashës», një herë tjetër «xhelat» dhe «që nuk vlen as për drejtor kopshti fëmijësh». Në një rast e ngrinte në qiell Titon dhe përvojën jugosllave, në një rast tjetër e cilësonte revizionizmin jugosllav «Kali i Trojës» dhe Titon si njeri që «nuk ecën me hapin e gjithë togës». Po kështu ai që i shtrënguar të dënonte me gjysmë zëri programin antimarksist të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (LKJ). Në këtë mënyrë grupi i Hrushovit shkonte përpara në rrugën e revizionizmit duke u përpjekur të çorodiste mendjet e njerëzve, duke kaluar nga oportunizmi në aventurizëm e anasjelltas dhe duke përgatitur goditjen vendimtare në shpinë të kamptit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Procesi i zgjerimit dhe i thellimit të revizionizmit po zhvillohej pa ndërprerje edhe në parti të tjera komuniste e punëtoresh në një numër vendesh socialiste e kapitaliste.

Vija dhe veprimtaria e revizionistëve, sidomos e udhëheqjes sovjetike e kishin shtuar çoroditjen ideologjike në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Këtë gjendje çoroditjeje në shumicën e vendeve socialiste dhe të partive komuniste e punëtore e shfrytëzonin imperia- listët amerikanë, gjithë kapitalizmi ndërkombëtar për zbatimin e strategjisë së tyre të shkatërrimit të sistemit socialist bo- tëror e të lëvizjes komuniste, të shtypjes së lëvizjes revolucio- nare çlirimtare, duke përdorur si taktikën e kundërrevolucio- nit paqësor, ashtu edhe ndërhyrjen e armatosur. Një plan të posaçëm kishte hartuar qeveria amerikane e Ajzenhaurit për të përmbysur pushtetin popullor edhe në Shqipëri.

Luftë pa kompromis për demaskimin e shkatërrimin e revizionizmit modern

Partia e Punës e Shqipërisë ndiqte me shqetësim të madh përhapjen e

revizionizmit dhe e quante luftën kundër tij si një nga detyrat e veta më të rëndësishme.

Shpallja e programit të LKJ i dha asaj një rast të volit- shëm për t'i dhënë revizionizmit ndërkombëtar goditje në të gjitha drejtimet e veprimtarisë dhe të ideologjisë së tij anti- marksiste. Duke demaskuar programin jugosllav si një grum- bull teorish të kalbura të Prudonit, Bernshtajnit, Kautskit, Trockit, Buharinut etj., të veshura me një petk të ri, Partia lë- shoi parullën: «Luftë pa kompromis për demaskimin dhe shka- tërrimin teorik e politik të revizionizmit modern»¹.

Duke e hedhur fjalën tërthorazi për qëndrimin oportunist që mbanin Hrushovi dhe revizionistët e tjerë në parti të ndry- shme komuniste e punëtore, PPSH theksonte: «Këtë rol që luan revizionizmi jugosllav në shërbim të imperialistëve nuk e sheh vetëm ai që me qëllim i mbyll sytë»².

Ajo organizoi botimin e një vargu artikujsh, me anën e të cilëve kritikoheshin ashpër pikëpamjet e revizionistëve, nxi- rreshin në shesh shtrembërimet që ata u bënë në mësimet the- melore të marksizëm-leninizmit, mbroheshin partia e klasës

1 Shih vendimin e Plenumit të KQ të PPSH, 20 qershor 1958. Do- kumente kryesore të PPSH, vëll. III, f. 208 dhe «Zëri i popullit», 22 qer- shor 1958.

2 Enver Hoxha. Revizionizmi modern duhet luftuar pa mëshirë deri në shkatërrimin e tij të plotë teorik e politik. «Zëri i popullit», 22 qershor 1958 dhe Vepra, vëll. 16, f. 58.

punëtores dhe roli i saj udhëheqës, diktatura e proletariatit dhe rruga revolucionare për kalimin në socializëm.

Duke i dhënë goditje revizionizmit ndërkombëtar në fushën ideologjike e politike, udhëheqja e PPSH ndiqte me vëmendjen më të madhe qëndrimet dhe veprimtarinë e N. Hrushovit e të grupit të tij. Ajo shikonte se ata po largoheshin përherë e më shumë nga parimet marksiste-leniniste. Procesi i njohjes së revizionizmit po thellohej vazhdimisht. Tek udhëheqja e PPSH po shtoheshin gjithnjë e më tepër dyshimet dhe rezervat ndaj udhëheqjes së PKBS. Kjo ndihmoi shumë që Partia të mos e lejonte veten të binte në asnjë nga kurthet që ngriti Hrushovi për ta thyer atë e për ta tërhequr në rrugën revizioniste. Udhëheqja revizioniste sovjetike ushqeui më kot shpresa se punët do të ndryshonin pas nënshkrimit të marrëveshjes për t'i dhënë RPSH një kredi të re për planin e 3-të pesëvjeçar, sidomos pas vizitës së Hrushovit në Shqipëri, në maj 1959.

Në kundërshtim me kërkesën këmbëngulëse të udhëheqjes sovjetike për të ndjekur kursin revizionist të saj, PPSH e vazhdoi me vendosmëri rrugën e vet marksiste-leniniste dhe e forcoi luftën për demaskimin e revizionizmit jugosllav dhe të revizionizmit modern në përgjithësi.

Me gjithë këto, deri në gjysmën e parë të vitit 1960 mosmarrëveshjet ideologjike ndërmjet PPSH dhe udhëheqjes sovjetike nuk ishin bërë të njohura botërisht dhe as ishin shtrirë në marrëdhëniet shtetërore midis dy vendeve.

Në të njëjtën kohë, PPSH tregonte vigjilencë të vazhdueshme për të shkatërruar planet e veprimtarinë armiqësore të imperialistëve amerikanë dhe të klikës së Titos kundër RPSH. Në verë të vitit 1960 u zbulua dhe u asgjësua një organizatë e fshehtë antishtetërore, në të cilën merrnin pjesë agjentë të vjetër të zbulimeve të huaja që kishin mundur të depërtonin në Parti, në organet shtetërore dhe në ushtri. Me këtë u shkatërrua komploti për organizimin e një kryengritjeje kundërrevolucionare dhe të një ndërhyrjeje të armatosur të bashkërenduar të Flotës VI amerikane, të monarkofashistëve grekë dhe të revizionistëve jugosllavë. U prish njëkohësisht edhe plani i udhëheqjes revizioniste sovjetike, e cila kishte dijeni për komplotin, e përkrahte atë dhe llogariste ta shfrytëzonte për qëllimet e veta.

Qëndrimi parimor marksist-leninist i PPSH në Mbledhjen e Bukureshtit

Nga fundi i vitit 1959 – fillimi i vitit 1960 PPSH kishte krijuar bindjen e plotë se udhëheqja sovjetike me Hrushovin në krye ishte revizioniste, tradhtare, se pikëpamjet e qëndrimet e saj të gabuara nuk ishin devijime të vogla, por largim nga marksizëm-leninizmi.

Me këtë bindje shkoi delegacioni i PPSH, i kryesuar nga shoku Hysni Kapo, në qershor 1960, në Bukuresht, për të marrë pjesë, përveç kongresit të PP të Rumanisë, edhe në një takim të përfaqësuesve të partive komuniste të vendeve të kampit socialist. Në këtë takim, sipas marrëveshjes paraprake, do të caktohej vendi e data e një mbledhjeje të partive komuniste e punëtore të botës. Ndërkaq Hrushovi kërkoi të bëhej mbledhja e delegacioneve të të gjitha partive, pjesëmarrëse në Kongresin e PPR, ku të diskutoheshin menjëherë mosmarrëveshjet që kishin lindur në mes të PKBS dhe PKK, në bazë të një materiali, të mbushur me padë kundër kësaj të fundit, që u shpërnda vetëm disa orë përpara.

Për këto mosmarrëveshje të thella KQ i PPSH kishte mësuar nëpërmjet polemikave të tërthorta në shtyp e nga bisedat e disa anëtarëve të Byrosë Politike të KQ të PPSH me udhëheqës sovjetikë e kinezë në Moskë e në Pekin.

Me t'u vënë në dijeni për mosmarrëveshjet midis dy partive më të mëdha komuniste, udhëheqja e PPSH kishte përcaktuar qëndrimin e vet të prerë: Këto mosmarrëveshje të zgjidheshin sa më parë në rrugën marksiste-leniniste në mes të PKBS e PKK. Po të mos zgjidheshin dot në mes tyre, atëherë të thirrej një mbledhje e përfaqësuesve të partive komuniste të kampit socialist. Pikëpamjet e qëndrimet e tyre të shtroheshin pastaj në një mbledhje të gjerë të partive komuniste e punëtore, si ajo e Moskës e vitit 1957¹. PPSH e vlerësonte zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë marksiste-leniniste midis PKBS dhe PKK si një çështje me rëndësi të madhe për unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për të ardhmen e këtij kampi e të kësaj lëvizjeje.

1 Enver Hoxha. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Bukuresht, 22 qershor 1960. Vepra, vëll. 19, f. 13.

I ndodhur përpara një gjendjeje tepër të rëndë, delegacioni i PPSH, i cili e kishte shumë të qartë këtë qëndrim revolucionar, njoftoi menjëherë KQ. Ky nxori përfundimin e drejtë se Hrushovi po kurdiste një komplot të madh kundër kampit socialist e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. PPSH duhej të përpiquej me çdo mënyrë për dështimin e këtij komploti. Delegacioni i saj në Mbledhjen e Bukureshtit duhej të mbronte pa u epur qëndrimin marksist-leninist të përcaktuar. «Mbledhjen që propozohet të bëhet tash në Bukuresht me të gjithë përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore motra, që kanë ardhur në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë, për mosmarrëveshje në mes të PK të BS dhe PK të Kinës, — i shkruante shoku Enver Hoxha shokut Hysni Kapo në përgjigje të njoftimit për këtë mbledhje, — udhëheqja jonë e konsideron të parakohshme dhe shumë të dëmshme»¹. Delegacioni i PPSH, duke theksuar në Mbledhjen e Bukureshtit këtë vlerësim dhe duke zbatuar udhëzimet e tjera përkatëse të KQ, e quajti atë një mbledhje krejt në kundërshtim me rregullat organizative e me praktikën e njohura në marrëdhëniet në mes partive komuniste e punëtore.

Hrushovi me shokë u tërbuan nga ky guxim i hapur i delegacionit të PPSH dhe e quajtën atë «një akt rebelimi».

Me gjithë përpjekjet këmbëngulëse, udhëheqja sovjetike në Mbledhjen e Bukureshtit nuk ia arriti dot qëllimit. Aty u vendos të thirrej një mbledhje e rregullt e të gjitha partive komuniste e punëtore në nëntor 1960. Për përgatitjen e saj u ngarkua një komision i posaçëm. Në të bënë pjesë përfaqësues të 26 partive, ndërmjet të cilave edhe PPSH.

Komploti ndërkombëtar i kurdisur nga grupi revizionist i Hrushovit dështoi. Në Bukuresht ai pësoi disfatën e tij të parë. Kjo ishte një disfatë për gjithë revizionizmin modern.

Kjo e përforcoi bindjen e PPSH se udhëheqja e PKBS me N. Hrushovin në krye përfaqësonte një klikë tradhtarësh dhe përbënte një rrezik të madh për marksizëm-leninizmin e socializmin.

Plenumi i KQ të Partisë në korrik 1960 e vlerësoi qëndrimin e delegacionit të vet në Bukuresht një qëndrim parimor marksist-leninist në mbrojtje të interesave të socializmit e të

1 Enver Hoxha. Letër e 22 qershorit 1960. Veprat, vëll. 19, f. 13-14.

lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ai njoftoi gjithë Partinë për zhvillimin e Mbledhjes së Bukureshtit dhe për komplotin e kurdisur atje nga N. Hrushovi. Organizatat-bazë të partisë gjetën njëzëri plotësisht me vend qëndrimin e KQ dhe të delegacionit të PPSH në atë Mbledhje. Ky qëndrim ishte rrjedhim logjik i tërë vijës revolucionare të ndjekur nga PPSH.

Qëndresa e vendosur e PPSH përballë sulmeve të udhëheqjes sovjetike Fill pas Mbledhjes së Bukureshtit, udhëheqja sovjetike u hodh në sulm të rreptë kundër

PPSH për ta gjunjzuar atë.

Goditjet u bënë në shumë drejtime. Në radhë të parë u vu në shenjë Komiteti Qendror i PPSH. Udhëheqja sovjetike u përpoq ta përçante, ta nënshtonte dhe të arrinte patjetër që ky të dënonte qëndrimin e vet në Bukuresht, duke marrë masa kundër «shkaktarëve».

Për këtë qëllim grupi i Hrushovit përdori Liri Belishovën, ish-anëtare e Byrosë Politike të KQ të PPSH, e molepsur me një ambicie të sëmurë mikroborgjeze dhe me ndjenjën e theksuar të karrierizmit. E përpunuar në Moskë dhe e nxitur prej këtij grupi, ajo u vu në opozitë me vijën e Partisë, duke u bërë përçuese e vijës antimarksiste të udhëheqjes sovjetike. Por përpjekjet e saj ndeshën në unitetin e çelniktë të Komitetit Qendror, në vendosmërinë e tij për të mos bërë asnjë lëshim në qëndrimet parimore dhe në kursin revolucionar marksist-leninist të Partisë. Kështu orvatja e grupit të Hrushovit për të ndryshuar ose lëkundur pozitat e Komitetit Qendror u shkatërrua.

Udhëheqja sovjetike, duke shfrytëzuar dashurinë e pakufishme të komunistëve shqiptarë për Partinë Bolshevike dhe Bashkimin Sovjetik, u mundua të ngjallte çoroditje dhe t'i ngrinte ata kundër udhëheqjes marksiste-leniniste të partisë së tyre. Ajo përdori personelin e ambasadës së vet në Tiranë, që gëzonte liri të madhe veprimi në Shqipëri, për të marrë takim me oficerë e gjeneralë, kuadro të partisë e të organeve shtetërore, punonjës të ekonomisë e të kulturës. Agjentët e Hrushovit u shfaqën atyre «shqetësimin» për «largimin prej vijës marksiste-leniniste» dhe për «tradhtimin e miqësisë sovjetoshqiptare» nga udhëheqja e PPSH! Pastaj u bënin pyetje provokuese: «Do të qëndroni me Bashkimin Sovjetik apo do të

kaloni kundër tij si po yepron udhëheqja juaj»? Grupi i Hrushovit i kishte varur sidomos shpresat e veta te kuadrot që kishin kryer studimet në shkollat sovjetike. Por të gjitha këto përpjekje dhe këto shpresa të tij u përmbysën. Revizionistët hrushovianë nuk gjetën e as shkaktuan dot ndonjë të çarë në radhët e Partisë. Pikërisht përballë këtij uniteti të çeliktë rreth Komitetit Qendror u asgjësuan planet e tyre.

KQ i Partisë protestoi pranë KQ të PKBS kundër të tilla presioneve e ndërhyrjeve të hapura në punët e brendshme të PPSH dhe të shtetit shqiptar. Ai protestoi gjithashtu kur mori vesh nga shtypi grek se Hrushovi i kishte deklaruar politikanit reaksionar grek, Venizellosit, në një bisedë me të, se kishte parë gjoja grekë në Korçë, gjatë vizitës në Shqipëri, dhe i kishte ledhatuar atij kërkesën shoviniste për «autonominë e Vorioepirit». Protesta u bë në edhe për qëndrime të tjera antishqiptare të udhëheqësve e funksionarëve të ndryshëm sovjetikë.

Përveç Liri Belishovës, grupi i Hrushovit vuri në veprim kundër PPSH edhe agjentin tjetër të tij, Koço Tashkon, ish-kryetar i Komisionit të Revizionimit të PPSH, i cili kishte shfaqur lëkundje të theksuara dhe ishte kritikuar shpesh për shmangie dhe qëndrime oportuniste. Si njëra dhe tjetri u përjashtuan nga Partia si armiq të saj.

Udhëheqja sovjetike i shtriu sulmet e veta edhe në lëmin ekonomik e kulturor. Pa përfillur marrëveshjet e përfunduara ndërmjet qeverive të RPSH dhe të BRSS ajo e ngadalësoi dhe në disa raste e ndaloi fare dërgimin e mallrave e të pajisjeve industriale në Shqipëri. Ajo kundërshtoi kërkesën për të dërguar një sasi drithi që të sigurohej buka, e cila mungonte për shkak të thatësisë së jashtëzakonshme të vitit 1960. Grupi i Hrushovit e përdori këtë rast si mjet presioni për ta detyruar PPSH të nënshtrohej, duke menduar se uria do ta shtrëngonte popullin shqiptar të ngrihej kundër saj. Ai iu kërcënua Partisë dhe Qeverisë së RPSH me prerjen e çdo lloj armatimi dhe pajisjeje ushtarake për Ushtrinë Popullore Shqiptare, sepse «ju, — deklaroi ai, — përkohësisht jeni në Traktatin e Varshavës».

Në gusht 1960, udhëheqja sovjetike i dërgoi një letër KQ të PPSH me anën e së cilës kërkonte që «Partia e Punës e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik të shkojnë në mbledhjen e ardhshme të nëntorit me unitet të plotë mendimesh!» Me fjalë të tjera PPSH duhej të hiqte dorë

nga qëndrimi parimor që mbajti në Bukuresht dhe nga vija e saj marksiste-leniniste. Ndryshe, kanosej grupi i Hrushovit, «shkëndija e keqkuptimit», të lindur në Bukuresht, «do të ndizet»!

PPSH nuk mund të pranonte kurrsesi një «unitet» të tillë që nuk do të ishte tjetër veç se një bashkëpunim kriminal. Prandaj ajo e hodhi poshtë kërkesën djallëzore të udhëheqjes revizioniste sovjetike.

Ndërkaq, delegacioni i PPSH në komisionin e 26 partive për hartimin dhe redaktimin e deklaratës së Mbledhjes së përgjithshme të partive komuniste e punëtore të botës luftonte me vendosmëri kundër përpjekjeve që bënin revizionistët për të hartuar një dokument antimarksist. Në këtë luftë ai zbatonte direktivën e KQ të Partisë: «Ne s'jemi për pikëpamjen «të ndreqet ç'mund të ndreqet...». *Ne jemi për atë që t'i shkohet çështjes deri në fund...* Revizionisti i vendosur nuk ndërroi rrugë... Kompromisi me ta nuk i shërben çështjes sonë»¹.

Në Tiranë, delegacioni i PPSH që do të merrte pjesë në Mbledhje, përgatitej për ndeshjen e ashpër që parashikohej të zhvillohej aty.

λ **Kritika e PPSH kundër** α **Delegacionin e PPSH në**
revizionistëve hrushovianë **Mbledhjen e 81 Partive Ko-**
në Mbledhjen e 81 Partive **muniste e Punëtore që u**
në Moskë **mbajt në Moskë, në nëntor**
1960, e kryesonte shoku
Enver Hoxha.

Delegacioni e kishte të qartë se kishte shkuar në një vend, ku fuqinë e kishin marrë në dorë revizionistët, të cilët do të silleshin si armiq kundrejt tij. Kjo u vërtetua me të arritur në Moskë. Presionet e provokimet qenë të hapëta. Hrushovianët s'lanë mjet pa përdorur që, në rast se nuk e nënshtronin, ta detyronin, të paktën, të mos dilte hapur në Mbledhje kundër Kongreseve XX e XXI të PKBS dhe të mos fliste për krimet që ata kishin kryer kundër Partisë dhe popullit shqiptar. Përdorën për këtë qëllim manovrat prej tregtari të premtimeve për ndihma më të mëdha ekonomike, të pranimit të ndonjë gabimi

¹ Enver Hoxha. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Moskë, 13 tetor 1960. Vepra, vëll. 19, f. 329, 330.

që «mund të kishin bërë funksionarët sovjetikë». Iu kërcënuan me prerjen e çdo ndihme e përkrahjeje, me «ndërtimin këtej e tutje të marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik e Shqipërisë mbi baza të tjera»!

Por asnjë lloj presioni e manovre nuk e lëkundti vendosmërinë e delegacionit shqiptar për të shprehur pa rezerva në Mbledhje pikëpamjet revolucionare, marksiste-leniniste të PPSH për problemet kryesore për të cilat kishin lidhur marrëveshje, për çështjet themelore të strategjisë e të taktikës së lëvizjes komuniste ndërkombëtare, duke demaskuar njëkohësisht tezat e qëndrimet revizioniste të grupit të Hrushovit për këto çështje, si edhe metodat antimarksiste që përdorte ai grup për t'i detyruar partitë e tjera të përqafojnë ato teza e qëndrime.

Në fjalën që mbajti në Mbledhje në emër të KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha hodhi poshtë pikëpamjet kundërrevolucionare të ndryshimit të natyrës së kapitalizmit e të imperializmit në kushtet e reja, që mbronin Hrushovi me revizionistët e tjerë për të përligjur bashkëpunimin me imperialistët amerikanë në krijimin e një «bote pa armë, pa ushtri e pa luftëra»! Imperializmi, në radhë të parë imperializmi amerikan, deklaroi ai, s'e ka ndërruar as lëkurën, as qimen, as natyrën. Ai është agresiv dhe do të jetë agresiv, sikur edhe një dhëmb t'i mbetet në gojë; rrjedhimisht, mund ta hedhë botën në luftë. Asnjë garanci absolute s'mund të ketë që nuk do të shpërthejë luftë botërore përderisa nuk ka triumfuar socializmi në gjithë botën ose në pjesën më të madhe të vendeve. «Kush nuk e sheh këtë ai është qorr. Kush e sheh por e mbulon, ai është tradhtar në shërbim të imperializmit»¹.

Duke e vlerësuar ruajtjen e paqes botërore si një detyrë shumë të rëndësishme, shoku Enver Hoxha mbrojti pikëpamjen revolucionare të PPSH se paqja nuk mund të ruhet me anë të bisedimeve boshe me krerët e imperializmit dhe duke u bërë lajka, përkëdhelje e lëshime imperialistëve amerikanë, duke kapitulluar përpara presionit të tyre. Që të ruhej e të forcohej paqja ishte e nevojshme të zhvillohej një luftë e vendosur politike dhe ideologjike për shkatërrimin e planeve agresive të imperialistëve, duke u kundërvënë atyre forcën vigane të bashkuar të kampit socialist, të proletariatit ndërkombëtar, të të gjitha vendeve e popujve liridashës e paqedashës.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 387.

Shoku Enver Hoxha kritikoi ashpër interpretimin dhe zbatimin oportunist nga udhëheqja sovjetike të çështjes së bashkëjetesës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, e cilësoi antimarksiste shpalljen prej saj të bashkëjetesës paqësore si vijë të përgjithshme të Bashkimit Sovjetik e të gjithë kampit socialist, rrugë kryesore për fitoren e socializmit mbi kapitalizmin. Bashkëjetesa paqësore, theksoi ai, përbën vetëm një ndër anët e politikës së jashtme të një vendi socialist. Anët e tjera, më të rëndësishme, të kësaj politike duhej të ishin bashkëpunimi vëllazëror e ndihma njëri-tjetrit midis vendeve socialiste, mbështetja pa rezerva e luftës revolucionare çlirimtare të masave punonjëse, të popujve të shtypur kundër imperializmit e reaksionit. Për hir të bashkëjetesës paqësore s'mund të hiqej dorë, siç vepronin hrushovianët, nga lufta e klasave në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, s'mund të kalohej në pajtim klasor e në bashkëjetesë ideologjike. «Përkundrazi, lufta e klasave duhet të vazhdojë, lufta politike dhe ideologjike kundër imperializmit, kundër ideologjisë borgjeze dhe asaj revizioniste duhet të forcohet gjithnjë e më shumë»¹.

Sipas pikëpamjes së PPSH, detyra kryesore e partisë komuniste të çdo vendi kapitalist është të ngrëjë masat në luftë kundër imperializmit dhe gjithë shërbëtorëve të tyre brenda vendit për të minuar sundimin e tyre, për të shkatërruar, në kushtet e një situatë revolucionare, pushtetin e tyre politik, për të vendosur pushtetin e popullit, për ta konsoliduar e për ta zhvilluar atë si diktaturë të proletariatit.

Vetëm kështu, me rrugë revolucionare e me dhunë sigurohet kalimi nga kapitalizmi në socializëm dhe jo me rrugë paqësore parlamentare. «Deri tani, — vuri në dukje shoku Enver Hoxha, — asnjë popull, asnjë proletarijat dhe asnjë parti komuniste ose punëtore s'e ka marrë pushtetin pa gjak dhe pa dhunë»². Kjo çështje ka qenë e qartë për marksistë-leninistët, kurse Hrushovi e ngatërroi dhe e shtrembëroi në drejtimin që u pëlqente oportunistëve. ✕

↙ Në mënyrë të veçantë, shoku Enver Hoxha kritikoi grupin e Hrushovit për qëndrimin kundërrevolucionar ndaj Stalinit. Ai e quajti dënimin e tij në Kongresin XX një veprim arbitrar, një gabim të rëndë. Çështja e Stalinit i përket gjithë lëvizjes ko-

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 391.

2 Po aty, f. 392.

muniste ndërkombëtare. PPSH, si repart i kësaj lëvizjeje, shprehte mendimin se «veprën e mirë e të pavdekshme të Stalinit duhet ta mbrojmë të tërë, kush nuk e mbron, ai është oportunist e frikacak»¹.

Stalini dhe Byroja Informative, nënvizoi shoku Enver Hoxha, kishin pasur plotësisht të drejtë që dënuan e demaskuan revizionizmin jugosllav si një rrymë kundërrevolucionare antimarksiste, si një agjenturë të imperializmit. Koha kishte vërtetuar plotësisht këtë vlerësim, prandaj lufta kundër tij mbejti një detyrë e vazhdueshme e partive komuniste. Por revizionizmi, vinte në dukje ai, nuk ndodhej e nuk vepronte vetëm në Jugosllavi. Ai po përhapej në mënyrë shqetësuese edhe në vende të tjera. Revizionistët ishin armiq të betuar të proletariaut, të revolucionit e të socializmit, përçarës të lëvizjes komuniste ndërkombëtare e të kampit socialist. Për këtë arsye, PPSH ngulte këmbë të ritheksohej vlerësimi që pati bërë Mbledhja e Moskës e vitit 1957 për revizionizmin modern si rreziku kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare e jo të hiqej dorë nga ky vlerësim, siç kërkonin Hrushovi me të tjerë, të cilët e quanin të kapërcyer (!) këtë rrezik.

Pasi tregoi me fakte rrezikun e madh që paraqiste revizionizmi duke sjellë ngjarjet në Hungari, në Poloni e gjetkë, për të cilat fajtorë të drejtpërdrejtë nuk ishin vetëm revizionistët hungarezë, polakë, jugosllavë etj. por edhe udhëheqja sovjetike, shoku Enver Hoxha thoshte: «Bëjmë pyetjen, përse ndodhën këto gjëra në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, në gjirin e kampit tonë pas Kongresit XX?

«Ne duhet të na shqetësojë jashtëzakonisht një gjë e tillë dhe duhet t'i gjejmë burimin sëmundjes e ta shërojmë. Sigurisht, sëmundja nuk shërohet as duke i fërkuar krahët renegatit Tito, as duke shënuar në deklaratë se revizionizmi modern është shpartalluar përfundimisht, siç pretendojnë shokët sovjetikë»².

Për t'i prerë rrugën revizionizmit, rëndësi të madhe kishte t'u jepej fund metodave të presioneve, ndërhyrjeve, komplotëve në marrëdhëniet midis partive komuniste. Duhej të dënohej sidomos komploti i grupit të Hrushovit në Mbledhjen e Bukureshtit, të cilën PPSH e quante «një njollë në lëvizjen komu-

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 457.

2 Po aty, f. 459-460.

niste ndërkombëtare»; të dënoheshin gjithashtu gjithë përpjekjet prej shovinistësh të shtetit të madh të udhëheqësve sovjetikë për t'i detyruar partitë e tjera të shkonin në Mbledhjen e Moskës me hapin e tyre të gabuar. Shoku Enver dënoi posaçërisht veprimet prej hegjemonisti e tregtari të këtyre udhëheqësve kundrejt Shqipërisë socialiste. Midis të tjerave, Hrushovi, pasi s'kishte mundur të nënshtronte delegacionin e PPSH, i kishte deklaruar delegacionit kinez: «Ne e humbëm Shqipërinë dhe ju e fituat atë»!!

Duke e vënë Mbledhjen në dijeni të veprimeve të tilla thellësisht antimarksiste të grupit të Hrushovit, shoku Enver Hoxha i drejtohej atij: «Ç'janë këto... trajtime prej «tregtari» ndaj Partisë, popullit tonë dhe një vendi socialist, i cili u humbka dhe u fituaka si një lojë bixhozi? ... Ju e konsideroni Shqipërinë si plaçkë tregu... Ka qenë një kohë kur Shqipëria konsiderohej si plaçkë tregu, kur të tjerët mendonin se varej nga ata në se Shqipëria do të ekzistonte apo jo, por ajo kohë ka marrë fund qysh me triumfin e ideve të marksizëm-leninizmit në vendin tonë»¹.

Delegacioni i PPSH e shpjegoi se me këtë kritikë të rreptë parimore që i bënte udhëheqjes sovjetike nisej vetëm nga qëllimi për të ruajtur unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të kampit socialist. Uniteti nuk mund të ruhej pa i nxjerrë në shesh gabimet dhe shfaqjet e këqija, pa i dënuar rreptë dhe pa i ndrequr ato mbi baza marksiste-leniniste. Atyre që përpiqeshin t'i mbyllnin gojën Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha u përgjigjej: «...askujt gjithashtu të mos i shkojë ndër mend se, meqë Shqipëria është e vogël, meqë Partia e Punës e Shqipërisë është e vogël, duhet të bëjë ashtu si thotë ndokush, kur ajo është e bindur se ai ndokushi gabohet...

«Të drejtën që të themi fjalën tonë na e ka dhënë marksizëm-leninizmi dhe këtë të drejtë neve nuk mund të na e heqë askush, as me presione politike apo ekonomike, as me kërcënime apo epiteje që mund të na ngjiten»².

Një mbrojtje të tillë të guximshme të marksizëm-leninizmit dhe një demaskim aq të mprehtë parimor të vijës e të veprimtarisë antimarksiste të hrushovianëve asnjë parti tjetër

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 424-425.

2 Pë aty, f. 394, 422.

nuk e bëri. Nuk e bënë partitë e tjera, sepse kush më shumë e kush më pak, ato ishin prekur nga sëmundja e revizionizmit, kurse PPSH e kishte mendimin dhe vijën e saj revolucionare të pastër.

Kundër grupit të Hrushovit foli edhe delegacioni kinez. Por qëndrimi i tij ishte në pozita pritëse, pajtuese, oportuniste e jo në pozita luftarake, sulmuese. Siç u bë e qartë më vonë, udhëheqja e PKK, ndryshe nga PPSH, nuk nisej nga qëllimi për të mbrojtur marksizëm-leninizmin dhe interesat e komunizmit ndërkombëtar, por për të mbrojtur interesat e ngushta shoviniste, hegjemoniste, sikundër edhe hrushovianët.

Fjala e shokut Enver Hoxha bëri një efekt të jashtëzakonshëm, të papritur për udhëheqësit sovjetikë e revizionistët e tjerë. Ajo e shkatërroi taktikën djallëzore të Hrushovit për të mbuluar kontradiktat e mosmarrëveshjet e thella në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për të shmangur kritikën e demaskimin e kursit të tij revizionist, të veprimtarisë së tij përçarëse. Me anë të kësaj taktike grupi i Hrushovit synonte t'ua linte gjithë fajin mbi kurriz Partisë së Punës të Shqipërisë dhe PK të Kinës, kundër të cilave qenë bërë shumë sulme e shpifje në një material, shpërndarë delegacioneve në prag të Mbledhjes, kurse vetë të dilte si flamurtar i marksizëm-leninizmit dhe i unitetit! Sikurse ka shkruar më vonë shoku Enver Hoxha, hrushovianët donin të luanin në Mbledhje rolin e «prokurorëve», kurse delegacionin e PPSH ta vinin në pozitën e të pandehurve. «Por, në kundërshtim me ç'ka deshën ata, u bëmë ne prokurorët dhe akuzuesit e renegatëve e të tradhtarëve. Ata ishin në bankën e të akuzuarve. Ne e mbajtëm kokën lart se ishim me marksizëm-leninizmin. Hrushovi mbante kokën me dy duar kur i binin bombat e Partisë sonë»¹.

Kritika parimore e drejtpërdrejtë e delegacionit shqiptar i dha zjarr polemikës. Delegacionet e partive të ndryshme u detyruan të shprehnin qëndrimin e vet për problemet në diskutim. Kundërsulmet e egra që shpërthyen revizionistët sovjetikë e të tjerë kundër PPSH, duke u përpjekur të asgjësonin efektin-bombë që ushtroi zëri i PPSH, nuk sollën gjë tjetër veçse e bënë atë më të fortë, më dërrmues. Ndikimi i luftës së dele-

1 Enver Hoxha. «Hrushovianët», f. 414.

gacionit të PPSH u shpreh edhe në Deklaratën e përbashkët që miratoi Mbledhja.

Në këtë dokument ndërkombëtar u mishëruan në përgjithësi parimet revolucionare marksiste-leniniste. Orvatja e revizionistëve hrushovianë për t'i imponuar lëvizjes komuniste ndërkombëtare vijën revizioniste pësoi disfatë. Vija marksiste-leniniste korri një fitore tjetër.

Përcaktimi që i bëri përmbajtjes së epokës sonë Mbledhja e Moskës e vitit 1957, si «kalim nga kapitalizmi në socializëm», në deklaratën e re u plotësua: «Epoka jonë, përmbajtjen kryesore të së cilës e përbën kalimi nga kapitalizmi në socializëm, që ka filluar me Revolucionin Socialist të Tetorit, është epoka e luftës së dy sistemeve shoqërore të kundërta, epoka e revolucioneve socialiste dhe e revolucioneve nacionalçlirimtare, epoka e shembjes së imperializmit, e likuidimit të sistemit kolonial, epoka e kalimit të popujve të tjerë në rrugën e socializmit, e triumfit të socializmit e komunizmit në shkallë botërore»¹.

Në këtë mënyrë iu pre mundësia revizionistëve për të spekulluar me përcaktimin jo të plotë të përmbajtjes së epokës sonë dhe për ta paraqitur atë si epokë të bashkëjetesës paqësore e të garës ekonomike pa revolucione dhe pa luftëra çlirimtare.

U flakën poshtë edhe një varg tezash revizioniste që përmbaheshin në projektdeklaratën e paraqitur nga udhëheqja sovjetike dhe që zbatoheshin prej saj në praktikë. Të tilla teza ishin: «bashkëjetesa paqësore është vija e përgjithshme e politikës së jashtme të vendeve socialiste»; «mundësitë për kalimin paqësor në socializëm po rriten gjithnjë e më shumë»; «në kohën e sotme ka mundësi të ndalohet çdo luftë» etj.

Kundër dëshirës së revizionistëve hrushovianë, në Deklaratën e Mbledhjes u bënë përcaktime të qarta si: — natyra e imperializmit nuk ka ndryshuar dhe ai mbetet baza për luftërat agresive; — forca kryesore e agresionit dhe e luftës është imperializmi amerikan; — ai është njëkohësisht kështjellë e reaksionit botëror dhe xhandar ndërkombëtar, armik i popujve të gjithë botës; — për të mënjанuar luftën botërore është e

¹ Deklarata e Mbledhjes së 81 Partive Komuniste e Punëtore, nëntor 1960.

nevojshme të ngrihen gjithë popujt në luftë kundër imperializmit, duke dhënë goditjen kryesore kundër imperializmit amerikan dhe duke krijuar një front të përbashkët antiimperialist; — luftërat nacionalçlirimtare përbëjnë një forcë të rëndësishme për ndalimin e luftës botërore; — këto luftëra duhet të gëzojnë përkrahjen e gjithanshme të vendeve socialiste, të lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare; — të gjitha partitë marksiste-leniniste janë të pavarura, të barabarta; — ato përpunojnë nëpërmjet këshillimesh pikëpamjet e tyre të përbashkëta dhe bashkërendojnë veprimet e tyre në luftë për të njëjtat qëllime etj.

Dështuan përpjekjet e shumta të revizionistëve hrushovianë për të lënë mënjanë përcaktimin që i bëri Deklarata e vitit 1957 revizionizmit si rrezik kryesor. Në Deklaratën e re u ruajt ai përcaktim. Përveç kësaj, u shtua: «Partitë komuniste dënuan njëzëri formën jugosllave të oportunitizmit ndërkombëtar, që është shprehje e koncentruar e teorive të revizionizmit të sotëm. Pasi tradhtuan marksizëm-leninizmin . . . , udhëheqësit e LKJ e shkëputën vendin e tyre nga kampi socialist, e vunë atë nën vartësinë e së ashtuquajturës «ndihmë» të imperialistëve amerikanë dhe të imperialistëve të tjerë. . Demaskimi i mëtejshëm i udhëheqësve revizionistë jugosllavë dhe lufta aktive për të ruajtur lëvizjen komuniste si edhe lëvizjen punëtore nga idetë antileniniste të revizionistëve jugosllavë vazhdojnë të mbeten një detyrë e domosdoshme e partive marksiste-leniniste»¹.

Megjithatë, në Deklaratë u pasqyruan edhe disa vlerësime jo të drejta, si vlerësimi për Kongresin XX të PKBS që u la ashtu si ishte hartuar në Deklaratën e vitit 1957, si edhe disa teza të gabuara. Për këto vlerësime dhe teza të gabuara PPSH kishte pikëpamje krejt të kundërta që i shprehu hapur edhe në mbledhje. Delegacioni i PPSH e nënshkroi Deklaratën duke u nisur nga përmbajtja e saj përgjithësisht e drejtë.

Veprimtarinë e delegacionit të PPSH në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste e Punëtore e pranoi njëzëri e plotësisht Plenumi i Komitetit Qendror në dhjetor 1960. Ai e vlerësoi

¹ Deklarata e Mbledhjes së 81 Partive Komuniste e Punëtore, nëntor 1960.

qëndrimin e delegacionit «të vendosur e parimor», kurse fjalën dhe gjithë punën e tij «shumë pozitive e të dobishme».

Qëndrimi i guximshëm parimor marksist-leninist i delegacioneve shqiptare në Mbledhjen e Bukureshtit dhe në Mbledhjen e dytë të Moskës, në rrethana aq të koklavitura që u krijuan nga veprimtaria e revizionistëve hrushovianë, tregonte shkallën e lartë të pjekurisë revolucionare të PPSH. Një qëndrim i tillë u bë shembull i madh për të gjithë komunistët shqiptarë në luftën e ashpër që kishte shpërthyer midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit modern. Simpatia dhe përkrahja e forcave marksiste-leniniste revolucionare të botës për PPSH u rrit edhe më shumë.